VENDIM
Nr.45, datë 16.1.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR INVENTARIN E SKEMAVE EKZEKUTUESE TË NDIHMËS SHTETËRORE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja "dh", e 18, shkronja "e" të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit për inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RAPORT
PËR INVENTARIN E SKEMAVE EKZISTUESE
TË NDIHMËS SHTETËRORE NË SHQIPËRI

1. Hyrje

Fusha e ndihmës shtetërore është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integrimit, detyrimet e së cilës përcaktohen në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe në nenin 37 të Marrëveshjes së Përkohshme.

Në këto nene shprehet qartë nevoja e përgatitjes së kuadrit ligjor, të harmonizuar me "*acquis communautaire"*, si dhe e ngritjes së strukturës së pavarur nga ana funksionale, që do të merret me kontrollin e skemave financiare të ndihmës shtetërore dhe ndihmave individuale që zbatohen në Shqipëri, si dhe që duhet të ketë të gjitha fuqitë e mjaftueshme ligjore për të kërkuar kthimin e ndihmave shtetërore të paligjshme.

MSA kërkon, gjithashtu, zbatimin e parimit të transparencës për të gjitha masat e ndërmarra nga organet e administratës qendrore dhe vendore, si dhe institucionet e tjera që veprojnë në emër të shtetit, që lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore. Për këtë, kërkohet përgatitja e një inventari gjithëpërfshirës së skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore dhe vlerësimi i tyre sipas standardeve europiane, i cili duhet t'i paraqitet Komisionit Europian.

Më konkretisht, neni 71/6 i MSA-së parashikon:

"Shqipëria do të hartojë një inventar gjithëpërfshirës së skemave të ndihmës, të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4 dhe të sigurojë pajtueshmërinë e këtyre skemave të ndihmës me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje."

Të njëjtin detyrim e përcakton edhe neni 37/6 i Marrëveshjes së Përkohshme, e cila ka hyrë në fuqi që nga 1 dhjetori 2006.

2. Kuadri ligjor dhe institucional për kontrollin e ndihmave shtetërore

Aktualisht, ekziston një kuadër i plotë ligjor në fushën e ndihmës shtetërore, i cili reflekton rregullat bazë të legjislacionit europian në këtë fushë. Përveç ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" dhe tri rregulloreve në zbatim të tij:

1. Rregullorja "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005.

2. Rregullorja "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 28.12.2005.

3. Rregullorja “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, janë miratuar:

- Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore” me vendim nr.1, datë 31.5.2006 dhe;
- Udhëzimi “Për paraqitjen e ankesave për ndihmat e paligjshme dhe vlerësimin e ndihmave të paligjshme” me vendim nr. 7, datë 20.10.2006.

Bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.182, datë 26.3.2006 “Për ngritjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore”, janë krijuar dhe funksionojnë të dy strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore: Drejtoria e Ndihmës Shtetërore (DNSH) në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH). DNSH është struktura e ngarkuar me detyrat tekniko-administrative për kontrollin e ndihmave shtetërore në Shqipëri. Ndërsa KNSH-ja është organi vendimmarrës, i cili ka kompetencë të autorizojë planet për dhënien e ndihmës shtetërore apo të urdhërojë kthimin e ndihmave të dhëna në mënyrë të paligjshme. Në bazë të dispozitave të ligjit, KNSH-ja është një organ kolegjial, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili gëzon pavarësi në ushtrimin e funksioneve të tij.

3. Inventari i skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore

Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 ka hyrë në fuqi duke filluar nga data 1 janar 2006 dhe i gjithë ky proces është paraprirë nga një sërë sesionesh trajnimi apo konsultimesh bilaterale me dhënësit e ndihmës në nivel qendror apo vendor.

Përveç dispozitave që përcaktojnë parimet dhe procedurat në dhënien dhe kontrollin e ndihmave shtetërore, në nenin 35 të tij, ligji përcakton detyrimin për dhënësit e ndihmës që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të raportojnë pranë DNSH-së të gjitha skemat ekzistuese të ndihmës.

Sikurse përcaktohet në ligj, skemë e ndihmës shtetërore është çdo akt normativ mbi bazën e të cilit, në formë të përgjithshme dhe pa pasur nevojën e akteve të tjera zbatuese, mund t’u jepet ndihmë ndërmarrjeve.

Ndërsa, ndihmë shtetërore ekzistuese, konsiderohet çdo skemë e ndihmës shtetërore, e dhënë para hyrjes në fuqi të ligjit dhe që zbatohet edhe pas hyrjes në fuqi të tij, si dhe çdo skemë e ndihmës shtetërore dhe ndihmë individuale, që është miratuar në përputhje me ligjin dhe rregulloret e nxjerrja në zbatim të tij.

Duke shqyrtuar legjislacionin shqiptar në fuqi, u bë një klasifikim i akteve normative që përmbanin elemente të ndihmës shtetërore. Konkretisht, u përgatit një listë, evidencë e këtyre akteve, e cila është shqyrtuar me imtësi nga stafi i DNSH-së dhe ekspertët e projektit CARDS 2002, duke eliminuar ato masa që nuk përmbanin elemente të ndihmës shtetërore. Për sa u takonte masave që përmbanin elemente të ndihmës shtetërore, nga institucionet përkatëse është kërkuar një informacion më i plotë dhe i detajuar, nëpërmjet plotësimit të formularëve të skemave ekzistuese. Pas shqyrtimit të të gjitha informacioneve dhe të dhënave të marra nga ministritë e linjës, janë regjistruar 15 skema ekzistuese të ndihmës shtetërore, të cilat përfshijnë ligje dhe vendime të Këshillit të Ministrave për mbështetjen nëpërmjet burimeve shtetërore në sektorë të tillë, si: sektori i ujësjellës-kanalizimeve, transporti hekurudhor i udhëtarëve, energjia dhe sektori i hidrokarbureve, industria minerare, turizmi, punësimi, shëndetësia etj. Gjithashtu, nga shqyrtimi i këtyre skemave vihet re se mbështetja nga ana e shtetit bëhet si nëpërmjet subvencionimit të drejtpërdrejtë, pra nëpërmjet zërit 603 të buxhetit, ashtu edhe nëpërmjet lehtësirave të ndryshme fiskale, si përjashtim nga taksat apo detyrimet doganore, shtyrje e pagesave apo shlyerje e detyrimeve të prapambetura etj. Më poshtë, po paraqesim në mënyrë më të detajuar instrumentet konkrete të përdorura në skemat ekzistuese të ndihmës shtetërore, analizën dhe vlerësimin e bërë nga strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore, së bashku me propozimet për rishikimin apo shfuqizimin e tyre.

4. Format e ndihmës dhe sektorët

4.1. Subvencione të drejtpërdrejta nga Buxheti i Shtetit

Në zërin 603 të Buxhetit të Shtetit, prej vitesh, ka pasur subvencionim për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, ku përfshihen arsimi, shëndetësia, shërbimet e interesit të përgjithshëm, bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia, transporti dhe telekomunikacionet, energjia, etj. Për një pjesë të këtyre sektorëve edhe aktualisht vazhdon subvencionimi, por, sikurse theksuam edhe më lart, nga shqyrtimi dhe

vlerësimi i masave, skemat e mbështetjes për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë u vlerësuan në kategorinë e masave me karakter të përgjithshëm dhe nuk u përfshinë në inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës. Tabela 1 paraqet subvencionet e dhëna nga Buxheti i Shtetit për periudhën 2001-2005.

Tabela 1: Subvencionet e akorduara nga buxheti i shtetit për periudhën 2001-2005 (në milionë lekë)

	Funksioni /Vitet	2001	Ne % ndaj totalit	2002	Ne % ndaj totalit	2003	Ne % ndaj totalit	2004	Ne % ndaj totalit	2005	Ne % ndaj totalit
1	Sherbime te pergjithshme publike *	71,60	**0,99**	965,00	**15,50**	2.260,00	**31,31**	85,00	**2,04**	85,00	**3,11**
2	Mbrojtja	-		-		-		-		-	
3	Rendi dhe siguria sociale	-		-		-		-		-	
4	Arsimi	540,00	**7,49**	542,80	**8,72**	627,02	**8,69**	600,00	**14,41**	710,00	**25,96**
5	Shendetesia	-		-		-		-		-	
6	Sigurimi dhe Ndihma Sociale	400,00	**5,55**	310,00	**4,98**	150,00	**2,08**	200,00	**4,80**	100,00	**3,66**
7	Strehimi dhe Sherbimet Komunale			71,00	**0,01**	-		800,00	**19,21**	780,00	**28,52**
8	Argetimi, Kulture dhe Ceshtje Fetare				**-**	-		-		-	
9	Energjia	5.850,00	**81,11**	3.780,00	**60,71**	3.800,00	**52,64**	1.700,00	**40,82**	-	
10	Bujqesia, Pyjet, Peshkimi dhe Gjuetia	226,00		244,00	**0,04**	227,50		330,00	**7,92**	610,00	**22,30**
11	Burimet Minerare				**-**	-		-		-	
12	Transporti dhe Komunikacionet **	565.47 *	**7,27**	434.78 *	**6,53**	581.09 *	**7,45**	450,00	**10,80**	450,00	**16,45**
13	Sherbime te tjera ekonomike	122,00	**1,69**	135,84	**0,02**	90,57	**1,25**	-		-	
14	Shpenzime te tjera	3,00	**0,04**	178,17	**2,86**	63,47	**0,88**	-		-	
	Totali	**7.212,60**		**6.226,81**		**7.218,56**		**4.165,00**		**2.735,00**	
	PPB	**590.282,41**		**628.527,45**		**694.019,64**		**752.367,77**		**822.034,56**	
	Subvencionet ndaj PPB ne %	**1,22**		**0,99**		**1,04**		**0,55**		**0,33**	

* Kjo kategori përfshin ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve
** Për vitet 2001-2003, në këtë grup perfshihet subvencioni i akorduar per sh.a Hekurudhat dhe per organet e qeverisjes vendore per transportin urban

Në inventarin e skemave ekzistuese është përfshirë subvencioni i drejtpërdrejtë për përballimin e shpenzimeve në sektorët që ofrojnë shërbime publike, kryesisht në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe në atë të transportit hekurudhor. Sigurisht një pjesë e këtij subvencioni është alokuar për të mbuluar diferencën midis çmimit dhe kostos së shërbimit që ofrohet. Megjithatë, nga analiza e bërë, rezulton se një pjesë e subvencionimit është bërë për të mbuluar shpenzimet operacionale të ndërmarrjeve përfituese dhe dhënia e subvencionit nuk i është nënshtruar një vlerësimi të kujdesshëm ekonomiko-financiar, në mënyrë që të shmangej çdo lloj mbikompensimi. Më konkretisht:

4.1.1 Skema ekzistuese për subvencionimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit

Kjo skemë synonte të ndihmonte ndërmarrjet e ujësjellësit, duke iu ofruar një subvencionim të përvitshëm nga Buxheti i Shtetit, në mënyrë që të mbulonin një pjesë të kostove operative: pagat, sigurimet shoqërore, blerjen e lëndëve kimike dhe shpenzimet për energjinë elektrike.

Si bazë për dhënien e subvencionit kanë qenë ligjet e Buxhetit të Shtetit, në zërin 603, shpenzime të përgjithshme publike, si dhe udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin përkatës financiar.

Të dhënat historike të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), tregonin se plani i subvencionit në Buxhetin e Shtetit çdo vit kishte parashikuar mbulimin e rreth 40 % të nevojave të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve. Pjesën më të madhe të kostos së këtyre shoqërive vazhdojnë ta përbëjnë shpenzimet për energji elektrike, të cilat po pësojnë rritje çdo vit (siç do të analizohet edhe më poshtë në skemën e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura).

Skema mund të justifikohej për shkak të natyrës së saj, meqenëse kontribuonte në një nga sektorët e ofrimit të shërbimit publik. Megjithatë, duke analizuar të dhënat u vu re se:

- Në dhënien dhe zbatimin e skemës në vite, nuk kishte pasur një plan të plotë e të mirargumentuar të zhvillimit të sektorit.

- Mungonte korrelacioni midis problematikës së ndeshur në ndërmarrjet e ujësjellësve dhe dhënies së subvencionit përkatës, pra nuk ishte bërë ndarja proporcionale e subvencionit, duke reflektuar mangësitë që ai duhej të rregullonte.

- Ndihma nuk ka qenë e kufizuar në kohë dhe nuk ishte zvogëluar në mënyrë progresive.

Në bazë të nenit 7 të rregullores "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005 ndihma operacionale, në parim është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur plotësohen kushtet:

1. ndihma është e justifikuar për shkak të natyrës së saj dhe për kontributin që jep në zhvillimin rajonal;

2. vlera e saj është në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë;

3. ndihma është e kufizuar në kohë dhe zvogëlohet në mënyrë progresive.

Siç u theksua edhe më sipër, kjo masë mund të klasifikohet si një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik, por ndihma për përmbushjen e detyrimeve të shërbimeve publike mund të lejohet, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. përfituesit i është përcaktuar qartë detyrimi i ofrimit të shërbimit publik;

2. parametrat për llogaritjen e ndihmës përcaktohen paraprakisht në mënyrë transparente dhe objektive;

3. ndihma nuk tejkalon kostot e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit publik;

4. ndihma e nevojshme për kompensimin e ofrimit të shërbimit publik përcaktohet mbi bazën e kostos që do të kishte një ndërmarrje efiçente.

Në këto kushte, KNSH-ja, mori vendimin nr. 5, datë 20.10.2006, ku propozoi që :

- MPPTT dhe Ministria e Brendshme (MB), në procesin e transferimit të së drejtës së pronësisë së ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt pushtetit vendor, të merrte parasysh subvencionimin e këtyre ndërmarrjeve për ofrimin e shërbimit publik.

- Masa e subvencionit të zvogëlohet në mënyrë progresive, të jetë e kufizuar në kohë dhe vlera e subvencionit të jetë në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë kjo lloj mbështetjeje. Pra, subvencioni të jepet pas një analize të plotë dhe të saktë të treguesve ekonomiko-financiarë të secilës prej ndërmarrjeve dhe të mbulojë, kryesisht, shpenzimet për investime.

- Subvencioni nuk duhet të tejkalojë kostot e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit publik dhe, në këtë rast, ofrimi i shërbimit duhet të ketë llogari të ndarë, për të shmangur çdo lloj mbikompensimi. Për përcaktimin e tarifave, rast pas rasti, dhënësit e ndihmës (MPPTT dhe organet e pushtetit vendor) duhet të bashkëpunojnë me Entin Rregullator të Ujit.

- Subvencioni për ndërmarrjet e ujësjellësit të përcaktohet nga dhënësit e ndihmës mbi bazën e kostos që do të kishte një ndërmarrje efiçente që do të ushtronte veprimtarinë në këtë sektor.

Vendimi i KNSH-së iu bë i ditur MPPTT-së dhe MB-së dhe iu kërkua që brenda 30 ditëve kalendarike të njoftonin me shkrim pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore pranimin e masave të propozuara.

MPPTT pasi u njoh me vendimin e marrë nga KNSH, u shpreh dakord me propozimet e dhëna. Gjithashtu, MPPTT-ja komentoi se ishte në fazën e decentralizimit të drejtimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe transferimit të këtij shërbimi drejt pushtetit vendor, megjithatë, siguroi që propozimet e paraqitura në vendimin e KNSH-së do të merreshin parasysh gjatë këtij procesi.

4.1.2 Skema ekzistuese e subvencionimit të hekurudhave

Kjo skemë synont të ndihmojë ndërmarrjen e hekurudhave, duke i ofruar një subvencionim të përvitshëm nga Buxheti i Shtetit, në mënyrë që të kompensohen kostot e ofrimit të shërbimit publik për këtë sektor, në veçanti, mbulimi i shpenzimeve operative të shërbimit të transportit të udhëtarëve. Pavarësisht se skema mbulon sektorin e transportit hekurudhor, përfituesi i saj është një ndërmarrje e vetme, Hekurudha Shqiptare sh.a. (HSH).

Si bazë për dhënien e subvencionit të hekurudhave është ligji nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005, si dhe udhëzimi nr.8, datë 27.1.2005 "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2005", si dhe të gjitha ligjet e buxhetit në vite.

Për çdo vit Buxheti i Shtetit, në formë subvencionesh, ka akorduar për HSH-në rreth 4 milionë USD për aktivitetin e operimit dhe 3-4 milionë USD për investime kapitale. Megjithë subvencionin e dhënë në vite, bilanci vjetor rezulton me humbje dhe nga analiza e treguesve u vu re se ndërmarrja, nuk kishte pasur në dispozicion fondet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe investimet, të domosdoshme për ta shndërruar atë në një ndërmarrje eficente.

Gjithashtu, u vu re se nuk ishin marrë masa konkrete për zbatimin e nenit 63, pika 1 të Kodit Hekurudhor, të miratuar me ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 në lidhje me përcaktimin e detyrimit të ofrimit të shërbimit publik të transportit të udhëtarëve, ku HSH-së duhej t'i jepej e drejta që të përshtaste tarifat e transportit me vlerën e pambuluar nga subvencioni. Por kjo gjë do të kërkonte në radhë të parë lidhjen e kontratës për detyrimin e ofrimit të shërbimit publik për transportin e udhëtarëve, si dhe ndarjen e llogarive të transportit të udhëtarëve me aktivitetet e tjera të ndërmarrjes.

Në analizë u mor parasysh edhe këndvështrimi i legjislacionit europian për këtë sektor, sipas

të cilit, kontributi nga Buxheti i Shtetit mund të lejohet në formën e ndihmës për ofrimin e shërbimit publik; ndihmës shtetërore për infrastrukturën, e cila mund të jepet si për kostot operacionale për menaxhimin dhe mirëmbajtjen në infrastrukturë, ashtu edhe në formën e granteve për investime në infrastrukturë, ndihmës shtetërore për normalizimin e llogarive, pra sistemimin e të gjitha llogarive, veçanërisht ato që lidhen me detyrime të mëparshme që i janë vendosur ndërmarrjes, si rezultat i transferimit të detyrimeve të ndërmarrjeve të tjera shtetërore, si dhe ndihmës shtetërore për ristrukturim, në mënyrë që të eliminohen kapacitetet e tepërta të ndërmarrjes, të tilla si:mbyllja e linjave apo aktiviteteve joefiçente, të shoqëruara me ristrukturimin e fuqisë punëtore (dhënia për punonjësit e larguar të një viti rrogë ose asistenca).

Në këto kushte KNSH-ja, mori vendimin nr. 8, datë 2.2.2007, ku propozoi që:

- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, brenda datës 31 mars 2007, të lidhte kontratën publike me Hekurudhën Shqiptare sh.a., në të cilën të përcaktohej qartë detyrimi i HSH-së për të ofruar shërbimin publik të transportit të udhëtarëve;

- Të bëhej ndarja e llogarive për pjesën që i takonte transportit të udhëtarëve nga veprimtaritë e tjera të HSH brenda datës 31 korrik 2007, në mënyrë që të përcaktohej saktë kosto e ofrimit të shërbimit publik;

- Të bëhej llogaritja e saktë e vlerës së kompensimit që mund të përfitonte HSH-ja për të ofruar këtë shërbim publik. Në rast se nuk do të kompensohej e gjithë shuma e nevojshme për ofrimin e shërbimit publik të transportit të udhëtarëve, atëherë të lejohej HSH-ja të përshtaste tarifat për vlerën e pambuluar nga subvencioni, dhe

- Së fundi, iu kërkua MPPTT të merrte të gjitha masat, deri në fund të vitit 2007, për përgatitjen e një plani për zhvillimin e sektorit hekurudhor, në mënyrë që ai të hapej për konkurrencë, duke filluar nga ndarja e menaxhimit të infrastrukturës prej shërbimeve të tjera të transportit hekurudhor.

MPPTT e vlerësoi si një kërkesë të avancuar dhe praktikisht të pamundur propozimin e KNSH-së për ndarjen e llogarive të transportit të udhëtarëve nga veprimtaritë e tjera të HSH-së brenda datës së përcaktuar në vendimin e KNSH-së, duke kërkuar realizimin e këtij detyrimi për periudhën në vazhdim. Lidhur me përshtatjen e tarifës për transportin e udhëtarëve, për vlerën e pambuluar të çmimit nga vetë HSH-ja, MPPTT-ja komentoi se nëse do të lejohej një veprim i tillë, kjo do të shkaktonte rritje të madhe të çmimit të biletave.

MPPTT-ja u shpreh dakord me propozimin për përgatitjen e një plani për zhvillimin e sektorit hekurudhor, duke e vlerësuar atë me hapa konkretë në realizimin e studimeve nga konsulentë të huaj. MPPTT-ja u shpreh se po punohej për hartimin e akteve nënligjore të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë me qëllim përshpejtimin e hapave për hapjen e tregut të transportit hekurudhor edhe për transportues të tjerë.

KNSH-ja, pasi shqyrtoi argumentet e paraqitura nga MPPTT-ja për moszbatimin e disa prej masave të propozuara prej tij, nuk i mori ato në konsideratë dhe me vendimin nr. 15, datë 15.3.2007, vendosi lënien në fuqi të masave të propozuara në vendimin e KNSH-së nr. 8, datë 2.2.2007.

Theksojmë se më datë 25.7.2007 ndërmjet MPPTT-së dhe HSH-së është nënshkruar kontrata për detyrimin e ofrimit të shërbimit publik për transportin e udhëtarëve dhe mbështetjen financiare nga ana e shtetit. Edhe kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 8 të KNSH-së, për ndarjen e llogarive të transportit të udhëtarëve parashikohet të përmbushet, duke filluar nga data 1.1. 2008.

4.2 Përjashtimi nga taksat

Në këtë kategori hyjnë disa skema, të cilat i janë nënshtruar një procesi rishikimi, gjatë kohës që ka hyrë në fuqi ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", ku përfshihen ligji "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", ligji "Për koncesionet", ligji "Për zonat e lira" dhe ligji "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore". Këto skema kanë pësuar amendime pjesore ose tërësore, duke synuar të përshtaten me legjislacionin evropian në fushat përkatëse.

4.2.1 Skema ekzistuese: ligji nr. 7665, datë 21.1.1993"Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" shfuqizuar me ligjin nr. 9734, datë 14.5. 2007 "Për turizmin"

Kjo skemë synonte nxitjen e investimeve në sektorin e turizmit, nëpërmjet përjashtimeve të ndryshme nga taksat, si dhe dhënies së garancive nga ana e shtetit për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në këtë sektor.

Skema fillestare, përfshinte personat e stimuluar, të cilët, sipas ligjit nr. 7665, datë 21.01.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", më konkretisht, neni 6, germat "d", "dh", "e" dhe "ë" të tij, kishin të drejtën të përjashtoheshin nga taksat e detyrimet doganore, si dhe të kundërbalanconin humbjet e pësuara gjatë 5 viteve të para të zhvillimit të veprimtarisë. Lejet e dhëna në bazë të atij ligji, janë aplikuar jo vetëm për zhvillimet e lidhura me turizmin, por edhe për forma të tjera zhvillimi brenda zonës, që kanë prekur qëllimin dhe theksin turistik të tyre.

Megjithëse në ligjin nr. 7665, datë 21.1.1993, "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" jepej e drejta e lidhjes së marrëveshjes për qiranë e tokës, në të nuk përcaktoheshin strukturat e menaxhimit dhe kontrollit, si dhe nuk krijohej lidhje ndërmjet mbështetjes së dhënë me kriteret dhe standardet e pritshme të zhvillimit. Gjithashtu, ka pasur mangësi të theksuara në të dhënat për zbatimin e skemës në vite.

Ndryshe nga ligji i vjetër, që përmbante në vetvete skema të drejtpërdrejta të ndihmës shtetërore për sektorin e turizmit, ligji i ri nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin", parashikon në formë të përgjithshme mekanizmat e mbështetjes financiare.

Ligji i ri parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për procedurat që duhen ndjekur për dhënien apo monitorimin e skemave mbështetëse për këtë sektor dhe ngarkon Agjencinë Kombëtare të Turizmit për hartimin e programeve financiare për mbështetjen e turizmit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për dhënien dhe menaxhimin e asistencës financiare për ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e turizmit.

Pavarësisht mendimeve që janë dhënë nga ana e DNSH-së në procesin e hartimit dhe miratimit të ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin", skema u shqyrtua në një analizë të veçntë nga, KNSH-ja, i cili , mori vendimin nr.18, datë 1.11.2007, ku, në veçanti:

- E konsideroi në përputhje me dispozitat e legjislacionit të ndihmës shtetërore në fuqi ligjin nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin" që ka shfuqizuar skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, ligjin nr. 7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin";
- Përcaktoi që të gjitha organet shtetërore që, në bazë të nenit 19 të ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin", ndihmojnë zhvillimin e turizmit duke propozuar politika të lehtësive fiskale për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike, janë të detyruar që, për çdo plan skeme ndihme apo ndihme të re individuale, të ndjekin të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.
- Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe organet e tjera shtetërore, brenda datës 31 mars të çdo viti, të raportojnë pranë DNSH-së për të dhënat e zbatimit të skemave të ndihmës dhe çdo ndihme individuale gjatë vitit paraardhës financiar në kuadër të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin";

- Agjencia Kombëtare e Turizmit të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale të përfituara në bazë të ligjit nr. 9734, datë 14.05.2007 "Për turizmin" deri pas 10 vjetësh nga data e dhënies së fundit së asistencës financiare në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

4.2.2 Skema ekzistuese: ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet"", shfuqizuar me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet".

Kjo skemë synonte nxitjen e investimeve nëpërmjet zhvillimit të veprimtarisë prodhuese dhe të shërbimit, nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare të formave të ndryshme në sektorë, të tillë si: industria e kromit, prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet lokale, ujësjellësat etj.

Si bazë për dhënien e ndihmës ka qenë ligji 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet" (në veçanti, neni 14 i tij), i shfuqizuar me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet".

Për marrëveshjet koncensionare, kontratat e miratuara ishin kryesisht sipas metodës me ofertë të pakërkuar, ndërsa investitorët privatë ishin, kryesisht, të huaj.

Ligji i vjetër kishte përcaktuar forma të ndryshme të mbështetjes shtetërore për kompanitë koncesionare, të tilla si: përjashtimin nga tatimi mbi fitimin, tarifat doganore, taksat e qarkullimit, taksat e importit etj.

Megjithëse, ligji parashikonte në formë të përgjithshme format e mbështetjes, pasi përjashtimet shqyrtoheshin rast pas rasti dhe, koncesionet e veçanta, jepeshin vetëm me miratimin e Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet një ligji të veçantë apo një marrëveshjeje, gjithashtu, të ratifikuar në Kuvend, nga kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të kontratave koncesionare të lidhura, si në industrinë e kromit, ashtu dhe në atë të energjisë elektrike, rezultoi se investimet nuk ishin realizuar në nivelin që

ishte parashikuar në projektet e miratuara.

Duhet të theksohet se, nuk ka pasur të dhëna të sakta për impaktin e pritshëm nga dhënia me koncesion e HEC-eve, përqindjen e nevojave për energji që parashikohet të mbulonin ato, impaktin që do të sillnin në zhvillimin e zonave të thella malore, investimet apo të ardhurat që do të realizoheshin prej tyre, si dhe treguesit e tjerë të lidhur me to, si punësimi etj.

Në pjesën më të madhe të marrëveshjeve nuk ka pasur të parashikuara sanksione në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e koncesionarëve. Edhe kur sanksionet kanë qenë të parashikuara në kontratat koncesionare, nga ana e autoriteteve shtetërore nuk janë marrë masa për zbatimin e tyre.

Në ligjin e ri, nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", si procedurë bazë për përzgjedhjen e koncesionarit, si për ofertën e kërkuar, ashtu dhe për atë të pakërkuar, është përcaktuar procedura konkurruese. Negocimi i drejtpërdrejtë është parashikuar të aplikohet vetëm për raste të veçanta dhe me miratim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ligji i ri përcakton qartësisht skemën institucionale, kompetencat dhe përgjegjësitë, si dhe procedurat përkatëse që lejojnë një praktikë transparente për të plotësuar në një nivel të ri dosjen e marrëveshjeve koncensionare, me dokumentacionin teknik dhe atë financiar, projektet dhe skemën financiare të administrimit të koncesionit, skemën e monitorimit dhe atë të kontrollit të zbatimit të kontratës etj.

Në këto kushte, KNSH-ja, mori vendimin nr.19, datë 1.11.2007, ku vendosi që:

- Në rastet kur kontratat koncesionare lidhen në bazë të metodës së negocimit, përpara lidhjes së kontratës duhet të merret miratimi i KNSH-së;

- Për asetet që jepen nën çmimin e tregut, të bëhet llogaritja e vlerës reale të tyre nga ekspertë të pavarur dhe, mbi këtë bazë, të llogaritet kontributi i përfituesit për financimin e investimit fillestar, i cili duhet të jetë të paktën në masën 25%. Nëse për lidhjen e kontratave koncesionare për vënien në përdorim të këtyre aseteve, nuk ndiqen procedurat e tenderit të hapur, për çdo rast duhet të merret miratimi paraprak i Komisionit të Ndihmës Shtetërore;

- Drejtoria e Licencave dhe Menaxhimit të Kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), brenda datës 31 mars të çdo viti të raportojë pranë DNSH-së për të dhënat e zbatimit të skemave të ndihmës dhe çdo ndihme individuale në kuadër të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncesionet", gjatë vitit paraardhës financiar;

- Drejtoria e Licencave dhe Menaxhimit të Kontratave në METE, të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale deri pas 10 vjetësh nga data e përfundimit të marrëveshjes së fundit koncesionare në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

4.2.3 Skema ekzistuese: ligji nr. 8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira", amenduar me ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike" ".

Kjo skemë kishte si qëllim shfrytëzimin e burimeve potencialeve në nivel lokal e kombëtar, rritjen e fuqisë konkurruese të bizneseve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në tregtinë ndërkombëtare, rritjen e nivelit të prodhimit, eksporteve, shërbimeve e punësimit, nxitjen e investimeve dhe transferimin e teknologjive të avancuara.

Si bazë për dhënien e ndihmës ka qenë ligji nr. 8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira", i shfuqizuar me ligjin e ri nr.9789, datë 19.7.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike".

Skema fillestare (neni 14 i ligjit), në parim, mbulonte mallrat e importuara si të përjashtuara nga detyrimet doganore, nga taksat e importit dhe lloje të tjera të kontrollit të importit, të cilat, në bazë të legjislacionit doganor të vendit tonë, gjejnë zbatim për mallrat që importohen në zona të tjera të vendit.

Gjithashtu, ligji përcaktonte edhe përjashtimin nga tatimi mbi fitimin për subjektet e licencuar, në 10 vitet e para të veprimtarisë së tyre në zonën e lirë.

Pavarësisht lehtësirave të dhëna, gjatë gjithë periudhës që ka qenë në fuqi ligji nr. 8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira", nuk ka pasur asnjë rast konkret të zbatimit të skemës.

Në ligjin e ri nr.9789, datë 19.7.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike" vazhdon të mbetet në fuqi përjashtimi nga detyrimet doganore dhe përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Skema e re nuk përmban elementet e ndihmës në formën e përjashtimit nga tatimi mbi fitimin për 10 vitet e para të veprimtarisë.

Por, në ligjin e ri, nuk është parashikuar ndonjë referencë në dispozitat e ligjit të ndihmës

shtetërore për miratimin e zonave të lira, apo të investimeve të veçanta në to. Për çdo plan ndihme individuale apo në formën e skemës, edhe në kuadër të zbatimit të këtij ligji, do të duhet të ndiqen procedurat e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore. Kjo, pasi incentivat fiskale mund të sjellin një sërë problemesh, të tilla si:

- mungesa e një lidhjeje midis përfitimeve dhe kostove të pranueshme;
- përfitimet nuk janë të kufizuara në kohë apo në vlerë;
- ndihma nuk ka karakter nxitës, pra të krijojë incentiva për të investuar nga ana e përfituesve;
- përfitimet jepen zakonisht në formën e ndihmës operacionale, e cila në parim është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur ajo është e mirargumentuar, e kufizuar në kohë dhe vlerë, shkon gjithmonë në ulje etj.

Gjithashtu, në përcaktimin e zonës së lirë, do të duhet të mbahen mirë parasysh edhe kushtet që duhet të plotësojnë ndërmarrjet që do të ushtrojnë veprimtarinë në këto zona ekonomike, në veçanti, ato që lidhen me: llojin e veprimtarisë që do të ushtrohet, kontributin në investime, punësim apo modernizim të veprimtarive ekonomike, afatet e fillimit të veprimtarisë prodhuese ose asaj të shërbimeve.

Në këto kushte, KNSH-ja, mori vendimin nr. 20, datë 1.11.2007, ku vendosi që:

- Në rregulloren për funksionimin e zonave ekonomike, që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike" të përcaktohet që për çdo rast të caktimit të zonës ekonomike, apo ndonjë veprimtarie të veçantë në të, në formën e ndihmës individuale, të merret miratimi paraprak nga KNSH-ja, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.
- Licenca për ushtrimin e veprimtarisë në zonën e lirë duhet të jepet në bazë të kritereve objektive dhe transparente.
- Në llogaritjen e intensitetit të ndihmës në kuadër të skemave apo në formën e ndihmave individuale nga zbatimi i këtij ligji, të merren parasysh të gjitha format e ndihmave që ndërmarrjet kanë përfituar apo mund të përfitojnë nga burime të tjera shtetërore.
- Në rregullore të përcaktohen edhe sanksionet që zbatohen për ndërmarrjet në rast të mospërmbushjes së angazhimeve të tyre për investime, punësim apo të gjitha kontributet e tjera, të përcaktuara në licencën për ushtrimin e veprimtarisë në zonën e lirë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare, brenda datës 31 mars të çdo viti të raportojë pranë DNSH-së për impaktin e investimeve dhe realizimin e të gjithë treguesve të tjerë gjatë vitit paraardhës financiar, të parashikuara në licencat përkatëse për ndërmarrjet që përfitojnë në kuadër të skemave apo në formë të ndihmës individuale nga dispozitat e ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike".
- Të dhënat për ndërmarrjet që përfitojnë nga skemat e ndihmës apo ndihmat individuale, si rezultat i zbatimit të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", të ruhen deri 10 vjet nga data e dhënies së licencës së fundit në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

4.2.4 Skema ekzistuese: "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore"".

Ligji nr.7675, datë 2.3.1993 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore" në nenin 3, shkronja "h" të tij parashikonte përjashtimin nga taksat doganore për medikamentet, pajisjet, aparaturat dhe materialet e konsumit mjekësor, pra përmbante elementë të ndihmës shtetërore.

Në kuadër të marrëveshjes së CEFTA-s, janë hequr të gjitha taksat doganore për mallrat dhe pajisjet e importuara. Në këtë kuadër, skema "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore" nuk është më në fuqi.

4.2.5 Një skemë tjetër që aplikon përjashtimin nga taksat është edhe skema ekzistuese: "Për përjashtimin e operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH".

Kjo skemë synon të ndihmojë ndërmarrjet që nënshkruajnë marrëveshje hidrokarburesh dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet, si dhe një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktuesve dhe nënkontraktuesve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.

Masa e dhënë nuk ka një afat të përcaktuar kohor. Në vitin 2005 dhe 2006 nga skema kanë

përfituar tre kontraktues dhe me dhjetëra nënkontraktues, ku përfshiheshin të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha, publike dhe private).

DNSH-ja gjatë vlerësimit të skemës konstatoi se në sektorin e hidrokarbureve funksionon një sistem i veçantë fiskal. Ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në këtë fushë, i nënshtrohen një tatimi mbi fitimin në masën 50%. Deri më sot, të gjitha ndërmarrjet që ushtronin veprimtarinë e tyre në bazë të kësaj skeme, nuk mbartnin detyrimin për pagesën e tatimit mbi fitimin, sepse nga aktiviteti i tyre nuk ishte zbuluar naftë, pra nuk ishte mundësuar shfrytëzimi i rezervave të reja të naftës dhe gazit dhe, për rrjedhojë nuk ka pasur shitje të produktit.

Megjithatë, nga vlerësimi i zbatimit të skemës në vite, rezulton se nga ana e AKH-së (sot AKBN) janë mbajtur të dhëna të sakta për investimet e kryera dhe të gjitha lehtësirat fiskale që janë përfituar nga kontraktorët dhe nënkontraktorët, rast pas rasti.

Në këto kushte, KNSH-ja, mori vendimin nr. 22, datë 12.12.2007, ku vendosi që:

1. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për rezultatet e zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure në vitin paraardhës financiar.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale deri pas 10 vjetëve nga data e përfundimit të marrëveshjes së fundit hidrokarbure në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

4.3 Falja e detyrimeve të prapambetura dhe gjobave

4.3.1 Skema ekzistuese e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror

Skema ekzistuese e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror është aplikuar për një periudhë afro 5-vjeçare, nëpërmjet një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave.

Skema synon mbështetjen e ndërmarrjeve me kapital shtetëror, nëpërmjet zvogëlimit të shumës së detyrimeve të prapambetura të kontabilizuara në pasqyrat e gjendjes pasurore, kryesisht të sektorit të ujësjellsave dhe minierave. Skema ka filluar të zbatohet që nga viti 2002 dhe fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim kanë qenë në rënie nga viti në vit. Kjo skemë është përgatitur në bashkëpunim me FMN-së, e cila monitoron rregullisht ecurinë e zbatimit të saj.

Skema gjatë viteve ka mbuluar sektorët e shërbimit të ujësjellsave dhe të industrisë minerare (minierat në likuidim dhe konservim), si dhe disa ndërmarrje të tjera me kapital shtetëror. Gjithashtu, përfitues të tërthortë nga skema janë KESH sh.a dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sh.a. Albpetrol sh.a., Armo sh.a.

Masa e dhënë klasifikohet si një ndihmë operacionale që jepet për të lehtësuar veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve përfituese, nëpërmjet reduktimit të një pjese të shumës së detyrimeve të akumuluara. Megjithatë, për sektorin e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, si sektori kryesor përfitues në kuadër të skemës, mbështetja mund të justifikohet për shkak të natyrës së saj, pasi furnizimi me ujë të pijshëm konsiderohet një shërbim me interes publik.

Ndërmarrjet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve kanë akumuluar në vite shuma të mëdha detyrimesh ndaj KESH sh.a. Shkak për këtë situatë ka qenë menaxhimi i dobët i veprimtarisë së tyre ekonomike në drejtim të kontrollit të humbjeve teknike në rrjet, faturimit të prodhimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga faturimet, si dhe detyrimi për ofrimin e shërbimit publik, duke mos orientuar çmimet drejt kostos.

Për vitet 2005 dhe 2006, intensiteti i ndihmës në kuadër të skemës së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve llogaritet në 24,8 %. Duke e akumuluar vlerën e ndihmës për këto ndërmarrje edhe me përfitimet që kanë marrë edhe nga skema e subvencionimit të drejtpërdrejtë, intensiteti arrin në masën 39,6 %. Ndërsa, për minierat në likuidim intensiteti për këtë periudhë llogaritet në masën 14%.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 aksionet e ndërmarrjeve të ujësjellës- kanalizimeve u transferohen njësive të qeverisjes vendore dhe detyrimet e prapambetura të tyre, deri në çastin e transferimit, do të shlyhen nga Buxheti i Shtetit, duke zhveshur bilancet e shoqërive nga ato detyrime përpara se të kryhet transferimi i aksioneve.

Duke pasur parasysh faktin që skema nuk zbatohet më për ndërmarrjet e sektorëve të industrisë minerare pra vazhdon vetëm për ndërmarrjet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe duke vlerësuar që masa lidhet me shpenzimet operacionale, por

1. ndihma është e justifikuar për shkak të natyrës së saj, pasi ka të bëjë me veprimtarinë e

ndërmarrjeve në një sektor jetik

2. vlera e saj është në përpjesëtim me mangësitë që kërkon të rregullojë, si dhe

3. ndihma është e kufizuar në kohë dhe zvogëlohet në mënyrë progresive (praktikisht skema përfundon së zbatuari me transferimin e paketës së aksioneve te pushteti vendor).

KNSH-ja, mori vendimin nr.21, datë 1.11.2007, ku vendosi që:

- Të lejojë zbatimin e skemës në bazë të rregullores "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale".

- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve të raportojë pranë DNSH-së për ecurinë e zbatimit të skemës deri në afatin e transferimit të ndërmarrjes së fundit drejt pushtetit vendor.

- Ministria e Punëve të Brendshme të raportojë brenda datës 31 mars të vitit 2008 pranë DNSH-së për vlerën totale të ndihmës së dhënë ndërmarrjeve të ujësjellësve, në kuadër të skemës, gjatë vitit 2007.

5. Kategoritë e ndihmës horizontale

5.1 Ndihma për punësim dhe për trajnim

Në kategorinë e ndihmave për punësim janë evidentuar 4 skema ekzistuese, të cilat janë hartuar dhe miratuar në zbatim të ligjit nr. 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit". KNSH-së, pas analizës së bërë nga ana e DNSH-së, vlerësoi se këto skema duhet të rishikoheshin sipas kritereve që përcakton legjislacioni i ndihmës shtetërore, madje për disa prej tyre u dha vendimi për një rishikim tërësor. Më konkretisht:

5.1.1 Skema ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë"

Skema synonte të mbështeste ndërmarrjet që mundësojnë marrjen në punësim të përkohshëm ose në punësim prove të punëkërkuesve të papunë nga lista e zyrës së punësimit, nëpërmjet një financimi mujor të pagës dhe të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme të këtyre personave.

Si bazë për dhënien e ndihmës kanë qenë nenet 6 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", si dhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69 datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë".

Skema ka filluar zbatimin e saj që në vitin 1999. Mbështetja për ndërmarrjet nëpërmjet kësaj skeme jepej për një periudhë 3-6 muaj. Megjithatë, skema në tërësinë e saj, nuk kishte të përcaktuar afatin e saktë kohor.

Në skemë nuk ishin parashikuar dispozitat sanksionuese për mospërmbushjen nga ana e ndërmarrjeve të detyrimeve të tyre në kuadër të skemës dhe as mënyra e raportimit të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e saj.

Në vlerësimin e strukturave të kontrollit të ndihmës shtetërore skema paraqitej shumë komplekse dhe nuk përmbante kritere të qarta për llogaritjen e intensitetit për secilin prej komponentëve të skemës, për kohëzgjatjen e saj, si dhe për monitorimin e impaktit që do të sillte zbatimi i secilit prej komponentëve dhe i skemës në tërësi. Gjithashtu, duke marrë parasysh që në analizë përfshihen edhe vlerat e pagesës së papunësisë dhe ndihmës ekonomike ishte pothuajse e pamundur që, me mënyrën sesi ishte parashikuar në skemë, por edhe në bazë të të dhënave të marra nga MPÇSSHB, të llogaritej dhe të vlerësohej intensiteti i ndihmës për të gjithë skemën.

Në këto kushte, KNSH-ja, mori vendimin nr.11, datë 15. 3. 2007, ku propozoi që skema të rishikohej tërësisht, mbi bazën e kritereve të përcaktuara në legjislacionin për ndihmën shtetërore. Gjatë procesit të rishikimit, gjithashtu:

- MPÇSSHB të përcaktonte saktë vlerën e intensitetit të ndihmës për çdo komponent të dhënë në skemë, si dhe vlerën e intensitetit total në kuadër të gjithë skemës.

- Të përcaktohej afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

- Të parashikohej që të gjitha ndërmarrjet që nuk plotësonin detyrimet e tyre në kuadër të skemës, të kthenin të gjithë ndihmën/subvencionin e marrë, së bashku me interesat, të llogaritura që nga data e dhënies së ndihmës.

5.1.2 Skema ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"

Skema synon të ndihmojë punëdhënësit që sigurojnë formimin nëpërmjet punës, të personave punëkërkues të papunë, të cilët janë persona profesionalisht të pakualifikuar për proceset e punës.

Si bazë për dhënien e ndihmës kanë qenë neni 6 i ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", si dhe pikat 1 dhe 2 të Vendim i Këshillit te Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë".

Skema përmban dy elemente ndihme:

-ndihma për trajnim, nëpërmjet formimit në punë për ata që vetëm trajnohen dhe nuk punësohen pas mbarimit të kursit të formimit; si dhe

- ndihma për punësim pasi ndërmarrja duhet të punësojë të paktën 40% të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në formim.

Intensiteti i ndihmës për elementin e parë ishte më i lartë se kufijtë e përcaktuar në ligjin e ndihmës shtetërore për ndihmën për punësim, dhe në rregulloren për ndihmën rajonale për nxitjen e punësimit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Intensiteti total i skemës tejkalon edhe më shumë kufijtë maksimalë të lejuar në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

Megjithëse udhëzimi nr.73, datë 14.1.2004 për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999, synon të përcaktojë procedurat e kontrollit dhe monitorimin e rezultateve të skemës, në zbatimin praktik ka munguar kontrolli i plotë mbi skemën dhe rezultatet e pritshme të saj.

Gjithashtu, në skemë nuk ishte përcaktuar detyrimi për kthimin e ndihmës, nëse ndërmarrjet nuk përmbushin angazhimet e tyre.

Në këto kushte, KNSH-ja mori vendimin nr.12, datë 15.3. 2007, ku propozoi që:

- Skema të rishikohej, duke ndarë në mënyrë të qartë komponentin për trajnim, nga ai për punësim,

- Që skema të bëhej e lejueshme duhet ose të ulet niveli i subvencionit, ose të rritet numri i punonjësve të cilët ndërmarrja është e detyruar t'i punësojë për të paktën një vit;

- Elementi i dytë, i paraqitur në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave, duhej të hiqej, pasi tejkalonte kufirin maksimal të intensitetit të lejuar të ndihmës; si dhe

- Të përcaktohej afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

5.1.3 Skema ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional"

Skema, në parim, mbulonte të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që ofronin kurse të formimit institucional për punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit, me kusht që të garantonin punësimin me kontratë të rregullt njëvjeçare të 20% të pjesëmarrësve në kurs.

Si bazë për dhënien e ndihmës kanë qenë neni 11, pika 1, e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", si edhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit te Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional".

Edhe kjo skemë përbëhej nga dy komponentë. Komponenti i parë lidhej me trajnimin e personave në vështirësi dhe punësimin e një pjese prej tyre. Ndërsa komponenti i dytë kishte të bënte me përballimin nga ana e shtetit të 60% të kostove të pranueshme për formimin profesional të punëkërkuesve të papunë. Intensiteti për komponentin e parë është mbi vlerën e intensitetit maksimal të lejuar si ndihmë për trajnim specifik (35%) dhe mbi vlerën e intensitetit maksimal të lejuar si ndihmë për punësimin e personave në vështirësi (50%).

Intensiteti i ndihmës për komponentin e dytë të skemës është brenda kufijve të intensitetit maksimal të lejuar për ndihmë për trajnimin e përgjithshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (70%) por mbi kufirin e lejuar për ndërmarrjet e mëdha (50%).

Gjithashtu, karakteri i përgjithshëm dhe i papërcaktuar i skemës deformohej në bazë të urdhrave të nxjerrë çdo vit nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, sipas të cilëve bëhej rishikim i grupeve përfitues nga skema, si dhe përzgjedhja e sektorëve që kanë përparësi.

Në këto kushte, KNSH-ja, mori vendimin nr.13 , datë 15.3.2007, ku propozoi që:

- Në mënyrë që skema të ishte e lejueshme, intensiteti i ndihmës së dhënë të rishikohej për komponentin e parë, duke mos tejkaluar kufijtë e përcaktuar në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

- Për komponentin e dytë u kërkua që të vendosej kushti që në rastin e ndërmarrjeve të mëdha shteti mund të financojë deri në 50% të kostove të përgjithshme të kursit.

- Të parashikohej se në dhënien e mbështetjes financiare ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për përmbushjen e programeve të formimit institucional, do të merren parasysh të gjitha format e mbështetjes që ndërmarrja/et mund të ketë marrë ose merr nëpërmjet programeve të tjera.

- Të përcaktohej afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

- Çdo projektakt normativ i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional", duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.

5.1.4 Skema ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë

femra”

Skema, në parim, synon të mbështesë të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që kanë si qëllim marrjen, në punësim me kontratë të rregullt, punëkërkues të papunë femra nga lista e zyrës së punësimit të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet pagesës së një pjese të kontributit të sigurimeve shoqërore dhe të pagave të tyre të punës. Skema ka diferencim në kontributin që jep shteti, kur punësimi bëhet me kontratë 1, 2 dhe 3-vjeçare.

Si bazë për dhënien e ndihmës kanë qenë nenet 4 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si edhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”.

Intensiteti i ndihmës së dhënë për vitin e parë ose dy vitet e para së bashku është brenda kufijve të përcaktuar në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ndërsa kur skema zbatohet për të tri vitet së bashku, intensiteti tejkalon vlerën maksimale të përcaktuar në ligj (por jo në rregulloren “Për ndihmën rajonale”.

Megjithatë, edhe këtu karakteri i përgjithshëm dhe i papërcaktuar i skemës, ndryshon me anë të urdhrave të nxjerra çdo vit nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, sipas të cilëve bëhet rishikim i grupeve përfitues nga skema, si dhe përzgjedhja e sektorëve/ndërmarrjeve që kanë përparësi.

Në këto kushte, KNSH-ja mori vendimin nr. 14 , datë 15.3.2007, ku propozoi që:

Në mënyrë që skema të jetë e lejueshme, intensiteti i ndihmës së dhënë të rishikohet kur skema zbatohet për tre vite, ose duke ulur vlerën e kontributit të sigurimeve shoqërore, ose duke ulur numrin e pagave me të cilat kompensohet ndërmarrja.

Në rast se nuk merret parasysh propozimi i pikës 1, MPÇSSHB kur zbaton skemën për tri vite, duhet të vendosë kushtin që ndërmarrja të jetë e detyruar të ruajë vendet e punës edhe për të paktën dy vjet pas përfitimit të vitit të tretë të ndihmës.

Çdo projekturdhër i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.

Për të gjitha skemat ekzistuese të ndihmës për punësim, KNSH-së vendosi gjithashtu që autoriteti përgjegjës për zbatimin e skemës të raportonte brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për zbatimin e skemës në vitin paraardhës financiar. Këto të dhëna duhet të ruhen deri në 10 vjet, pasi është dhënë ndihma/subvencioni i fundit në kuadër të skemës.

MPÇSSHB, pasi u njoh me vendimet e KNSH-së, u shpreh dakord lidhur me propozimet e bëra dhe këtë gjë po e konkretizon me rishikimin tërësor të Vendim i Këshillit te Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë” dhe vendimit të Këshillit te Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”. Gjithashtu, është bërë amendimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.508, datë 8.8.2007 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra””, ku janë pasqyruar të dy kushtet e përcaktuara në vendimin e KNSH-së.

6. Sektori i bujqësisë

Sektori i bujqësisë dhe i peshkimit është i përjashtuar nga fusha e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Megjithatë, në bazë të kapitullit II të MSA-së dhe marrëveshjes për bujqësinë të OBT-së, vendi ynë ka detyrime për ndihmën shtetërore në fushën e bujqësisë, të cilat janë shprehur në mënyrë substanciale në tekstin e marrëveshjes. Ndërsa detyrimet specifike për vendin, janë paraqitur në aneksin e Marrëveshjes për bujqësinë të OBT-së, ku thuhet se maksimumi i lejuar i subvencioneve në bujqësi nuk duhet të kalojë 5% të GDP-së së sektorit për vitin përkatës.

Për 3 skemat ekzistuese të raportuara nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), KNSH-ja, pas kategorizimit të tyre, ka dhënë rekomandimet përkatëse. Format e përdorura të ndihmës kanë qenë:

- përjashtimi, ulja dhe diferencimi nga taksat, konkretisht në skemat “Për përjashtimin nga akciza e karburantit të përdorur në linjat e agropërpunimit” dhe “Për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e përpunimit të qumështit, ullirit,

rrushit dhe bluarjes së grurit", si dhe

- garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulëta, ku përfshihej skema "Për huanë e butë që jepet për makineritë bujqësore dhe për linjat e agropërpunimit".

Nga analiza e këtyre skemave, pavarësisht veçorive të secilës prej tyre, u vu re se:

- Mungonin të dhënat për llogaritjen e vlerës së ndihmës, sipas sektorëve e nënsektorëve përkatës, gjë që e bënte të pamundur përcaktimin e intensitetit të tyre
- Mungonte një klasifikim i plotë i përfituesve në bazë të sektorëve përkatës;
- Mungonte analiza e leverdisshmërisë së investimeve të kryera e, për rrjedhim, edhe e impaktit ekonomik që ato sjellin.

Në këto kushte, KNSH-ja, rekomandoi që:

- MBUMK-ja të bëjë një klasifikim të saktë të subjekteve përfituese mbi bazën e nënsektorëve të veçantë dhe të administrojë të dhënat për secilën nga ndërmarrjet që kanë përfituar duke llogaritur, njëkohësisht, edhe vlerën totale të ndihmës.

- Llogaritja e intensitetit të skemës, të bëhet duke iu referuar treguesve të GDP-së së secilit prej nënsektorëve, duke mos kaluar në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së.
- MBUMK-ja të marrë parasysh vlerën kumulative të të gjitha skemave të ndihmës që jepen në sektorët e bujqësisë, pasi kufiri prej 5% përfshin të gjitha format e ndihmës për këta sektorë.

Në përfundim të këtij raporti mund të thuhet se, nga ana e dhënësve të ndihmës në nivel qendror, ka filluar me seriozitet puna për përshtatjen e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore me kriteret e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore. Shembull për këtë janë përgatitja dhe miratimi i ligjeve të reja në fushën e turizmit, koncesioneve dhe zonave të lira. Gjithashtu, masa po merren në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, si dhe në atë të transportit hekurudhor, për zbatimin e masave të propozuara nga KNSH-ja.

Tabela e inventarit të skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore

Nr.	Nr. i rregjistrit	Titulli i skemës	Sektori përfitues	Kategoria e përgjithshme e ndihmës	Forma konkrete e ndihmës	Vlera totale e ndihmës (mln lekë)	Intesiteti në %	Dhënësi i ndihmës	Agjensia zbatuese	Objektivat e ndihmës	Baza ligjore (akti normativ)	Vendimi i KNSH	Fletore Zyrtare
1	AI/011/2005	Për huanë e butë që jepet për makineritë bujqësore dhe për linjat e agropërpunimit	Bujqësia-agropërpunimi	Hua shtetërore	Hua me interesa të buta nën vlerën e tregut	828.07 milion lekë		Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit		Nxitja e SME-ve për kryerjen e investimeve	Ligji nr. 8828, datë 05.11.2001 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit nëpërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për Projektin e Shërbimeve Bujqësore"	Nr. 2, datë 20.10.2006	Nr. 117, datë 15.11.2006
2	AI/010/2004	Për përjashtimin nga akciza e karburantit të përdorur në linjat e agropërpunimit	Bujqësia-agropërpunimi	Lehtësi fiskale	Përjashtim nga taksa e akcizës për lëndët djegëse		n.a	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit		Ndihme për fermerët	Neni 19 i Ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për Akcizat"	Nr. 3, datë 20.10.2006	Nr. 117, datë 15.11.2006
3	AI/009/2005	Për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e përpunimit të qumështit, ullirit, rrushit dhe bluarjes së grurit	Bujqësia-agropërpunimi	Lehtësi fiskale	Përjashtim nga TVSH		10% pra është 5% më pak nga kushti i parashikuar në dispozitën e Ligjit "Për ndihmën shtetërore"	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit		Nxitja e prodhimit bujqësor nga SME	Ligji nr. 9162 datë 18.,02.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar"	Nr. 4, datë 20.10.2006	Nr. 117, datë 15.11.2006
4	AI/014/2005	Për subvencionimin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve	Ujësjellës-Kanalizime	Grante	Subvencion nga Buxheti i Shtetit	3,902.00	14	MPPTT	Drejtoria e Përgjithshme e Ujrave	Kompensimi i kostos së ofrimit të shërbimit publik/shpenzime operative	Ligji për buxhetin e shtetit në vite	Nr. 5, datë 20.10.2006	Nr. 117, datë 15.11.2006
5	AI/015/2005	Për subvencionimin e Hekurudhave	Transporti Hekurudhor	Grante	Subvencion nga Buxheti i Shtetit	2,560.00	50.8	MPPTT	Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionev e	Kompensimi i kostos së ofrimit të shërbimit publik të transportit të udhëtarëve	Ligji për buxhetin e shtetit në vite	Nr. 8, datë 2.02.2007, Nr.15, datë 15.03.2007	Nr.13, datë 16.02.2007 , Nr.31, datë 23.03.2007
6	AI/006/1/2005	Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë	Punësimi	Grante	Subvencion nga Buxheti i Shtetit	267.20	n.a.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Nxitjen e punësimit	Neni 6 dhe 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", pikat 1 dhe 2 e VKM-së nr. 69 datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë"	Nr. 11, datë 15.03.2007	Nr.31, datë 23.03.2007

Tabela e inventarit të skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore

Nr.	Nr. i rregjistrit	Titulli i skemës	Sektori përfitues	Kategoria e përgjithshme e ndihmës	Forma konkrete e ndihmës	Vlera totale e ndihmës (mln lekë)	Intesiteti në %	Dhënësi i ndihmës	Agjensia zbatuese	Objektivat e ndihmës	Baza ligjore (akti normativ)	Vendimi i KNSH	Fletore Zyrtare
7	AI/006/2/2005	Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë	Punësimi	Grante	Subvencion nga Buxheti i Shtetit	433.70	> 71.4	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Nxitjen e punësimit	Neni 6 i ligji nr. 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", pika 1 e VKM-së nr. 73 datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"	Nr. 12, datë 15.03.2007	Nr.31, datë 23.03.2007
8	AI/006/3/2005	Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional	Punësimi	Grante	Subvencion nga Buxheti i Shtetit	107.50	80 %, 60 %	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Nxitjen e punësimit	Neni 11, pika 1, e ligjit nr. 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit" dhe pikat 1 dhe 2 të VKM-së nr. 74 datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional"	Nr. 13, datë 15.03.2007	Nr.31, datë 23.03.2007
9	AI/006/4/2005	Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra	Punësimi	Grante	Subvencion nga Buxheti i Shtetit	73.57	35.6, 46.9 dhe 56 %	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Nxitjen e punësimit	Nenet 4 dhe 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit" dhe pikat 1 dhe 2 të VKM-së nr. 632 datë 18.09.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra"	Nr. 14, datë 15.03.2007	Nr.31, datë 23.03.2007
10	AI/004/2005	Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin	Turizmi	Lehtësi fiskale	Përjashtimi nga taksa e transferimit mbi dividentët, nga taksa doganore dhe akcizat mbi mallrat e sendet e importuara, nga tatimi mbi fitimin, etj...	n.a	n.a	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Agjensia Kombëtare e Turizmit	Nxitja e investimeve në sektorin e turizmit	Ligji nr. 7665, datë 21.01.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" shfuqizuar me ligjin nr. 9734, datë 14.05.2007 "Për turizmin"	Nr.18, Datë 1.11.2007	Nr.159, datë 30.11.2007
11	AI/003/2005	Për koncesionet	Koncensionet	Lehtësi fiskale, Garanci shtetërore	Përjashtim nga taksat mbi fitimin, tarifat doganore, taksat e qarkullimit, taksat mbi importet, reduktim i taksave, garanci të ndryshme shtetërore, si: sigurimi i aseteve, garantimi i blerjes së mallrave apo shërbimeve, etj.	2, 241.02 milion lekë për vitet 2001- 2007	n.a	Ministria Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës	Drejtoria e Licensave dhe Koncesioneve	Nxitjen e investimeve	Ligji 7973, datë 26.07.1995 "Për koncesionet" shfuqizuar me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për Koncesionet",	Nr. 19, Datë 01.11.2007	Nr.159, datë 30.11.2007